

**STATUTI**  
**I SHOQËRISË AKSIONERE ME OFERTË PRIVATE**  
**“O-SP Albania” SHA.**

**Pjesa e përgjithshme**

Aksionari i shoqërisë :

- **ARMANDO METALIAJ**, i biri i Deli-ut, i datëlindjes 26.05.1984, lindur në Bajram Curri dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I40526044K

bazuar në aktin e themelimit të shoqërisë, ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare” (i ndryshuar); ligjin nr. 9879, datë 21.02.2008 “ Për titujt” dhe ligjin nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” (i ndryshuar), sot më datë 23.02.2021 miraton statutin e shoqërisë aksionare me ofertë private “**O-SP Albania**”SHA SHA si më poshtë vijon:

**KREU I**

**Emri, Forma, Zyra Qendrore, Objekti i Veprimtarisë, Kohëzgjatja, Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit**

**NENI 1**

**Emri**

Shoqëria tregtare mban emrin “**O-SP Albania**”.

**NENI 2**

**Forma**

Shoqëria tregtare “**O-SP Albania**” ka formën e një shoqërie aksionare me ofertë private “**SHA**”.

**NENI 3**

**Zyra Qendrore**

Zyra qendrore e shoqërisë aksionare me ofertë private “**O-SP Albania**”SHA është në adresën Fshati Muçaj, Vorë, me Nr.Pasurie 321/29, Zona Kadastrale 2726.



**NENI 4**  
**Objekti i Veprimtarisë**

Shoqëria tregtare “**O-SP Albania**”SHA ka si objekt të veprimtarisë së saj:

- Import, eksport, shitje dhe tregëtim me shumicë dhe pakicë, transport dhe magazinimi i gjithë produkteve të naftës dhe nënprodukteve të saj, gazit dhe produkteve energjetike.
- Import, transport, tregtim dhe magazinimi i vajrave lubrifikantë.
- Shitje pjesëve të këmbimit, gomave, riparim makinash. Riparim dhe mirëmbajtje e pjesëve mekanike dhe të mortorrit. Riparim dhe mirëmbajtje karrocerie. Riparim dhe mirëmbajtje impjanti elektrik. Riparim dhe mirëmbajtje e gomave. Mbledhje, depozitim, shkatërrimi i mjeteve rrugore ose i pjesëve të tyre të dala jashtë përdorimit apo të braktisura.

**NENI 5**  
**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e aktivitetit të Shoqërisë aksionare me ofertë private “**O-SP Albania**”SHA do të jetë me afat të pacaktuar.

**NENI 6**  
**Degët dhe Zyrat e Përfaqësimit**

Shoqëria aksionare me ofertë private “**O-SP Albania**”SHA mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë vendit, si dhe mund të jetë pjesë e grupimeve të shoqërive.

**KREU II**  
**Kapitali i Shoqërisë, Zmadhimi/Zvogëlimi i Kapitalit, Aksionet, Kalimi i Aksioneve**

**NENI 7**  
**Kapitali i Shoqërisë**

7.1 Kapitali i Shoqërisë aksionare me ofertë private “**O-SP Albania**”SHA është 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë, i përbërë nga kapital në para. Ky kapital ndahet në 350 aksione, me vlerë nominale 10.000 (dhjetë mijë) lekë secila.

7.2 Aksioneri ka kontribuar në kapitalin e shoqërisë si më poshtë vijon:

- Z. Armando Metaliaj ka nënshkruar 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) lekë dhe ka shlyer  $\frac{1}{4}$  e këtij vlere të përbërë nga kontribut në para, sipas vërtetimit të lëshuar nga Banka Kombëtare Tregtare , bashkëngjitur këtij Statuti.



7.3 Në bazë të kontributeve të derdhura aksionari Z.Armando METALIAJ, është zotëruar i 350 aksioneve të cilat përbëjnë 100% të kapitalit të shoqërisë.

#### **NENI 8**

#### **Zmadhimi/Zvogëlimi i Kapitalit të Shoqërisë**

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet ose zvogëlohet në çdo kohë me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve të shoqërisë. Për zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të shoqërisë do të respektohen dispozitat ligjore në fuqi.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të zmadhohet nëse nuk janë shlyer ende kontributet për aksionet e nënshkruara më parë.

#### **NENI 9**

#### **Aksionet**

Aksionet e shoqërisë janë të zakonshme dhe kanë të njëjtën vlerë. Çdo aksion është i barasvlershëm me një votë dhe i jep çdo aksionari të drejtën e votës në raport proporcional me pjesën e kapitalit që përfaqëson. Në momentin e regjistrimit të shoqërisë aksionarëve iu jepet një certifikatë aksionesh e cila përmban emrin/mbiemrin e aksionarit, numrin e aksioneve të zotëruara prej tij, vlerën nominale të aksionit. Certifikata e aksionit lëshohet në bazë të Regjistrimit të Aksioneve.

Aksionet e pashlyera duhet të shlyhen nga aksionari brenda 31.12.2021

#### **NENI 10**

#### **Kalimi i Aksioneve**

10.1 Aksionet e shoqërisë mund të kalohen tërësisht ose pjesërisht të tretëve.

10.2 Në rast se shoqëria do të ketë më shumë se një aksionar, aksionet e shoqërisë mund t'u kalohen tërësisht ose pjesërisht të tretëve që nuk bëjnë pjesë në shoqëri me kushtëzimet e mëposhtme:

a) Aksionarët e shoqërisë kanë të drejtën e parablerjes për aksionet që dëshirojnë të shesë njëri prej aksionarëve të shoqërisë.

Aksionari që dëshiron të shesë aksionet e tij ia ofron ato aksionarëve të tjerë nëpërmjet Këshillit Mbikëqyrës.

Aksionarët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes së aksioneve me të njëjtat kushte dhe me të njëjtin çmim që aksionari mund t'ia shesë ato një të treti që nuk bën pjesë në shoqëri.

Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e paraqitjes së ofertës, aksionarët e tjerë duhet të përgjigjen për ushtrimin e të drejtës së parablerjes ose, në të kundërt, do të konsiderohet

se ata kanë hequr dorë prej saj. Në rast se aksionarët që do të ushtrojnë të drejtën e parablerjes janë më shumë se një, aksionet ndahen ndërmjet tyre në pjesë të barabarta.

- b) Në rast se aksionari që tjetëron aksionet e tij, ia shet ato një të treti jashtë shoqërisë, me çmim dhe kushte më të favorshme nga ato që ua ka ofruar aksionarëve të shoqërisë për efekt të ushtrimit të së drejtës së parablerjes nga ana e tyre, atëherë kontrata që aksionari do të lidhë me personin e tretë do të jetë e pavlefshme dhe Këshilli Mbikëqyrës nuk do të japë miratimin për këtë kalim.

### **KREU III**

#### **Organet e Shoqërisë, Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i Administrimit, Administratori**

### **NENI 11**

#### **Organet e shoqërisë**

Organet e shoqërisë aksionare me ofertë private “O-SP Albania”SHA janë:

- Asambleja e Përgjithshme;
- Këshilli Mbikëqyrës;
- Administratori.

### **NENI 12**

#### **Asambleja e Përgjithshme**

#### **12.1 Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme.**

Asambleja e Përgjithshme është organi më i lartë vendimmarrës i shoqërisë. Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme detyrojnë të gjithë aksionarët, pavarësisht nëse votojnë kundër apo mungojnë. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për:

- përcaktimin e politikave tregtare;
- ndryshimin e statutit;
- emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës dhe emërimin dhe shkarkimin e Administratorit të shoqërisë;
- emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve;
- emërimin dhe shkarkimin e ekspertëve kontabël të autorizuar;
- miratimin e skemës së shpërblimeve për anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës dhe ekspertët kontabël të autorizuar;
- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit themeltar;
- riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- të gjitha çështjet e tjera të parashikuara nga ligji.

## **12.2 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme.**

Asambleja e Përgjithshme mbledhet së paku një herë në vit. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nga Administratori, Këshilli Mbikëqyrës ose nga aksionarët të cilët përfaqësojnë të paktën 5% të kapitalit të regjistruar të shoqërisë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Asambleja e Përgjithshme mund të thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrim ose nëpërmjet postës elektronike. Adresat ku do të bëhen këto njoftime i deklarohen Administratorit nga Aksionari/Aksionarët dhe regjistrohen prej tij në Regjistrin e Aksionarëve.

Njoftimi i mbledhjes së bashku me rendin i ditës iu dërgohet të gjithë aksionarëve 21 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e Asamblesë.

## **12.3 Pjesmarrja dhe përfaqësimi në Asamble.**

Votat e aksionarëve kanë vlerë proporcionale me pjesën e tyre në kapitalin e shoqërisë. Çdo aksionar ka të drejtën e një vote.

Çdo aksionar mund të përfaqësohet në Asamble në bazë të një autorizimi nga një aksionar tjetër apo nga një person i tretë. Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Aksionarët mund të marrin pjesë në mbledhje edhe me anë të mjeteve të ndryshme të komunikimi apo elektronike (skype, etj), me kusht që të pasqyrohet në procesverbal identifikimi i tyre.

## **12.4 Drejtimi i mbledhjes dhe procesverbalet.**

Mbledhjet e Asamblesë drejtohen nga Kryetari i cili zgjidhet me vendim të aksionareve për të drejtuar mbledhjen. Kryetari zgjedh mbajtësin e procesverbalit. Procesverbali përban:

- Datën dhe vendin e mbledhjes,
- Numrin e aksionarëve të pranishëm dhe kuorumin e arritur,
- Drejtuesin e mbledhjes, dhe të mbajtësit të procesverbaleve
- Rendin e ditës,
- Dokumentet e raportet që janë diskutuar,
- Një përmbledhje të debateve,
- Rezultatet e votimeve.
- Vendimet e marra
- Qëndrimet e kryetarit për vendimmarrjen si dhe të aksionareve që janë shprehur kundër.

Procesverbalit i bashkëngjiten edhe lista e pjesëmarrësve dhe dokumentacioni i thirrjes së Asamblesë së përgjithshme. Të gjitha vendimet e Asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal. Procesverbali nënshkruhet nga kryetari dhe mbajtësi i procesverbalit.

Proces-verbalet e mbledhjeve ruhen në selinë e shoqërisë nga administratori i cili është dhe përgjegjës për ruajtjen e tyre.

## **12.5 Kuorumi dhe votimi.**

Për marrjen e vendimeve të cilat kërkojnë një shumicë të zakonshme Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme, vetëm nëse marrin pjesë aksionerët me të drejtë vote, të cilët

zotërojnë më shumë se 30% të aksioneve të kapitalit të shoqërisë. Në këtë rast, Asambleja e Përgjithshme vendos me shumicën e votave të aksionerëve pjesëmarrës.

Asambleja e Përgjithshme vendos me  $\frac{3}{4}$  e votave të aksionerëve pjesëmarrës për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, miratimin e kalimit të aksioneve të tretët, ushtrimin e së drejtës së parablerjes së aksioneve, anulimin e aksioneve, largimin e aksionerit dhe për të gjitha çështjet e tjera të parashikuara nga ligji dhe statuti. Për këto çështje, Asambleja e Përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse janë të pranishëm personalisht aksionerët të cilët zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave.

### **NENI 13**

#### **Këshilli Mbikëqyrës**

Këshilli Mbikëqyrës i shoqërisë zgjidhet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve të shoqërisë me shumicë të thjeshtë votash. Ai përbëhet nga 3 (tre) anëtarë të cilët qëndrojnë në detyrë për 3 vjet.

Këshilli Mbikëqyrës si rregull mbledhet së paku 1 (një) herë në 3 (tre) muaj. Vendimet e Këshillit Mbikëqyrës janë të vlefshme, nëse në procesin e vendimmarrjes janë të pranishëm më shumë se  $\frac{1}{2}$  e anëtarëve të Këshillit.

Këshilli Mbikëqyrës ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;
- b) të përgatisë, me kërkesë të asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t'i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t'u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;
- c) të thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme për interesat e shoqërisë;
- ç) të kujdeset që shoqëria të respektojë ligjin dhe standardet e kontabilitetit;
- d) të shqyrtojë e të kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
- dh) të sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera të raportimit e publikimit, të detyrueshme në bazë të ligjit apo statutit, të kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet të miratohen e të nënshkruhen nga të gjithë e anëtarët e këshillit mbikëqyrës për t'iu paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport të këshillit mbikëqyrës për miratim dhe një përshkrim për mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë të gjithë vitit financiar;
- e) të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e raporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit mbikëqyrës. Raporti i mbikëqyrës, përmendur në shkronjën "dh" të kësaj pike, duhet të përmbajë edhe mendimin për raportin e auditimit;
- ë) të përcaktojë shpërblimin e administratorëve;
- f) të kryejë veprime të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Anëtarë të parë të Këshillit Mbikëqyrës janë:

1. **ERIS AHMETAJ**, i datëlindjes 10.04.1987, lindur në Lezhë dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I70410076N.
2. **BESMIR TRASHI**, i datëlindjes 28.02.1987, lindur në Ngurës i Vogël dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I70228028J.
3. **IRIDA ÇAUSHI**, e datëlindjes 26.08.1989, lindur në Kavajë dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I95826094A.

#### NENI 14

#### **Administratori**

Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë. Ai emërohet dhe shkarkohet nga Asambleja e Përgjithshme. Ai emërohet në detyrë për një periudhë 3 vjeçare.

Administratori ka këto të drejta dhe detyra:

- a) të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë;
- b) të përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) të kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) të përgatisin dhe të nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë, të cilët ia paraqesin këshillit mbikëqyrës për miratim, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, për t'u paraqitur më pas për miratim nga asambleja e përgjithshme;
- d) të krijojnë një sistem monitorimi e njoftimi të hershëm për rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;
- dh) të kryejnë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të të dhënave të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo të ligjeve të tjera;
- e) të raportojnë përpara Këshillit Mbikëqyrës për zbatimin e politikave tregtare dhe, me realizimin e veprimeve me rëndësi të veçantë, për veprimtarinë e shoqërisë.

- Administrator i parë i shoqërisë është **ARMANDO METALIAJ**, i biri i Deli-ut, i datëlindjes 26.05.1984, lindur në Bajram Curri dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal I40526044K

#### NENI 15

#### **E Drejta e Informimit**

Aksionarët e shoqërisë kanë të drejtë të kërkojnë nga Këshilli Mbikëqyrës dhe/apo Administratorët të gjithë informacionin për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë, raportet e

organeve drejtuese, raportet e ekspertëve kontabël, llogaritë vjetore të shoqërisë, llogaritë e konsoliduara si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë. Në rast se Këshilli Mbikëqyrës dhe/apo Administratori nuk ia vë në dispozicion aksionarëve materialin për të cilin ata kanë kërkuar informacion, atëherë aksionarët mund ti drejtohen gjykatës për nxjerrjen e një urdhri ekzekutimi për përmbaruesin gjyqësor, me qëllim ekzekutimin e kërkesës së aksionarit.

#### **KREU IV**

#### **Viti Financiar, Rezerva Ligjore, Deklarimi i Dividendit**

#### **NENI 16**

#### **Viti Financiar dhe eksperti kontabël**

Viti financiar fillon me i Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

Auditimi i pasqyrave financiare të shoqërisë do të bëhet nga eksperti kontabël i autorizuar **Leze ABAZI** e datëlindjes 26.01.1963, lindur në Blalke dhe banues në Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, shtetas shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit me numër personal G35126037W.

#### **NENI 17**

#### **Rezerva Ligjore**

Nga fitimi i tatuar, i realizuar gjate vitit financiar paraardhës, pasi janë zbritur shpenzimet, shoqëria kalon 5% të vlerës në rezervën ligjore derisa kjo rezervë të jetë e barabartë me 10% të kapitalit themeltar. Shoqëria mund të krijojë dhe rezerva të tjera nga fitimet vjetore.

#### **NENI 18**

#### **Deklarimi i Dividendit**

Nga vlera e fitimeve vjetore, secilit aksionar i jepet dividendi si pjesë e fitimit që i takon në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar që aksionet e secilit aksionar përfaqësojnë. Shpërndarja e dividendit bëhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme. Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë që shoqëria të mos shpërndajë dividendë ose që fitimi vjetor të mos u paguhet aksionarëve, port ë përdoret për qëllime të tjera.

#### **KREU V**

#### **Prishja e Shoqërisë, Likuidimi, Falimentimi, Bashkimi, Ndarja dhe Shndërrimi i Shoqërisë**

#### **NENI 19**

#### **Prishja e Shoqërisë**

Shoqëria tregtare me ofertë private “**O-SP Albania**” SHA, prishet:

- me vendim të Asamblesë së Përgjithshme;
- me hapjen e procedurave të falimentimit;



- nëse nuk kryen veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me legjislacionin në fuqi;
- me vendim gjykate.

Vdekja e një aksionari nuk sjell si pasojë prishjen e shoqërisë.

Ne rastin e prishjes së shoqërisë, administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen në QKR. Nëse prishja bëhet me vendim gjykate, gjykata regjistron këtë vendim kryesisht.

#### **NENI 20**

##### **Likuidimi**

Prishja e shoqërisë sjell si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit. Për likuidimin e shoqërisë vendimi merret nga Asambleja e Përgjithshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë të ndjekë procedurën e likuidimit të thjeshtuar ose procedurën e likuidimit të zakonshëm në gjendje të aftësisë paguese. Në rastin e dytë asambleja mund të caktojë një ose disa likuidatorë, i cili/të cilët nga moment i emërimit marrin përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorit. Likuiduesi përgatit një bilan të gjendjes së shoqërisë në momentin e hapjes së procedurës së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së procedurave. Bilanci përfundimtar i nënshtrohet miratimit të Asamblesë së Përgjithshme.

#### **NENI 21**

##### **Falimentimi**

Nëse shoqëria nuk është në gjendje të paguajë detyrimet e saj ndaj kreditorëve, dhe pasuria e saj nuk mjafton për të mbuluar pretendimet e kreditorëve përfshirë dhe kontributet e pashlyera, atëherë Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë nisjen e procedurave të falimentimit.

#### **NENI 22**

##### **Bashkimi, Ndarja dhe Shndërrimi i Shoqërisë**

Shoqëria aksionare me ofertë private “O-SP Albania” SHA, mund të riorganizohet nëpërmjet bashkimit me një shoqëri tjetër, ndarjes në dy apo më shumë shoqëri të tjera ose shndërrimit të formës së saj ligjore. Për bashkimin, ndarjen apo shndërrimin e shoqërisë do të jetë i aplikueshëm legjislacioni shqiptar në fuqi.

#### **KREU VI**

##### **Dispozita të fundit**

#### **NENI 23**

##### **Mosmarrëveshjet**

Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij Statuti, midis aksionarëve, të punësuarve dhe personave të tretë, si dhe çdo mosmarrëveshje tjetër që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt kompetente për zgjidhjen e tyre mund të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor ku shoqëria ka zyrën qendrore.

#### **NENI 24**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen kryesisht dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

**Ky Statut hartohet dhe firmoset në 4 (katër) origjinale, të gjitha me të njëjtën vlerë ligjore. Një kopje qëndron në dokumentacionin bazë të Shoqërisë.**

**AKSIONARI I VETËM**

**ARMANDO METALIAJ**

